

**AKT- THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM ,**  
**TRAVEL AND TRANSPORT” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM , TRAVEL AND TRANSPORT” Sh.p.k.

- 1- **MIMOZA MURATI** , atesia **PELLUMB**, shtetase **SHQIPTARE**, lindur me 16/04/1987 ne **SKRAPAR**, identifikohet nepermjet kartes se identitetit Nr. 175416072V;
- 2- **TALAL ABU MAYHA** , atesia **AHMAD**, shtetas **SHQIPTAR**, lindur me 03/11/1976 ne **KUWAIT**, identifikohet nepermjet kartes se identitetit Nr. H61103137B;

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM , TRAVEL AND TRANSPORT” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1**  
**FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM , TRAVEL AND TRANSPORT” Sh.p.k.,

**NENI 2**  
**BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3**  
**SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “BRIGADA 8” Pallati 21. Hyrja 4, kati 9, apartamenti 38 , Tirane, Shqiperi

**AKT THEMELIMI “ GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM,TRAVEL AND TRANSPORT” SHPK**

1

*Mimoza Murati*  
h

*Talal Abu Mayha*



Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

#### NENI 4

### KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve të parashikuara me ligj.

#### NENI 5

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM , TRAVEL AND TRANSPORT" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe shërbimeve ndaj shoqërive në Republikën e Shqipërisë dhe në territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Shërbime në fushën e transportit të udhëtareve, Shërbime transporti taksi. Shërbime transporti me autobus dhe minibus. Shërbim taksi i një niveli të lartë bashkëkohor, me një nivel të lartë dhe trajnimi të vazhdueshëm të personelit të shërbimit (shofer), operator të vazhdueshëm taksi me një paketë të përshtatshme në ndihmë të mbrojtjes së ambientit, studime dhe menaxhim të vazhdueshëm të tregut, pajisjen e automjeteve me GPS, dërgimit të mjetit duke minimizuar kohën e pritjes. Shërbime taksi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Transporti urban dhe interurban në funksion të shërbimit Taxi të udhëtarëve, në përputhje me çdo ligj të zbatueshëm dhe rregullore të fushës përkatëse. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me të. Dhënie me qira e makinave, motorëve, minibus, autobus personave të tretë. Tregtim, shërbim me qira me drejtues mjeti. Tregtim blerje dhe shitje automjeteve Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shërbim me taksi brenda dhe jashtë vendit, transport udhëtarësh kombëtar (Brenda qytetit dhe nderqytetas) dhe nderkombëtar, si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar me ligj. Tregtim me pakice të pjeseve të kembimit për automjete. Në fushën e transportit, hapjen e agjensive të transportit të udhëtareve si brenda edhe jashtë vendit, car - rental, pika servisi, parkim automjeteve, lavazh, pike karikimi për mjete motorike elektrike (makina, microbus, autobus...). Transporti

AKT THEMELIMI "GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM, TRAVEL AND TRANSPORT" SHPK

2

*Dimos Dushaj*  
D

*Edi Rama*  
Edi Rama



tokesor, detar dhe ajror i mallrave dhe udhetareve per vete dhe per te tretet. Ushtimi I aktivitetit te linjave ajrore per transportin e personave, te mallrave dhe postes, jo vetem ne udhetime te linjes por edhe me udhetime jo te linjes(charter).Blerjen shitjen , dhenien me qira dhe zhvillimin e pasurive te paluajtshme, veprime logjistike si dhe çdo aktivitet tregtar te lidhur me to;themelimin e siper marrjeve te perbashketa ose ortakëve me pale te treta; shitblerjen e kuotave dhe aksioneve ne shoqeri te tjera;marrjen edhe dhenien e e huave; vendosjen e hipotekave, pengjeve ose garancive te tjera; çdo aktivitet tjetër te lejuar nga legjislacioni shqiptar.

2.Operator turistik. Agjenci turistike dhe udhëtimesh. Shitje dhe blerje biletash avioni, trageti, autobuzi. Shitje dhe blerje të paketave turistike me grupe të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Aktivitet shkollimi e trainimi per nevojat e veta e te te treteve ne te gjitha fushat e turizmit Makina me qira, siguracion shëndeti në udhëtim. Organizime turesh Brenda dhe jashtë vendit. Pushime dhe udhëtime me korçera. Transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit për vete dhe të tretë Marrje e dhenie me qira te mjeteve te transportit tokesor, detar, ajror.Marrje e dhenie me qira te hoteleve,restoranteve,bareve,qendrave pushuese... Shitjen e paketave te udhetimesh cdo gje perfshire transport bashke me akomodimin e programeve turistike e sherbime ne toke.Aktivitet shkollimi e trainimi per nevojat e veta e te te treteve ne te gjitha fushat e turizmit.

. Shoqëria mund të nënshkruajë kontrata apo të jetë palë kontraktuese për marrëveshjet civile apo tregtare me institucione shtetërore, publike apo private në lidhje me kryerjen e shërbimeve sipas objektit të kontratës apo të marrë pjesë në tendera, në marrëdhënie civile, tregtare brenda dhe jashtë Shqipërisë për interesat e shoqërisë. Shoqëri mund të marrë pjesë personalisht apo të jetë palë në marrëdhënie kontraktore me shoqëri të tjera, si dhe ushtimin e çdo veprimtarie të ligjshme. Shoqëria mund të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me shoqëri të tjera që operojnë në fusha të ndryshme të së drejtës civile e tregtare shqiptare, të ketë të drejtën e shitblerjes së kuotave të ortakëve apo ortakut të vetëm të një shoqërie tjetër, të ofrojë garanci të çdo lloji që parashikon ligji për aktivitetin e ligjshëm të çdo subjekti fizik apo juridik privat. Dhenie e konsulences ne te gjitha fushat e aviacionit,turizmit,hotelerise e mirembajtes teknike e te kontabilitetit.Perpunimi e perdorimi per nevojat e veta e te te treteve perfshire shitje e dhenie me qira te programeve kompjuterike ne fushen e aviacionit,turizmit e te mirembajtjes. Administrimi i pasurive te paluajtshme,terreneve e strukturave sociale si dhe shitblerje dhe dhenie me qira te tyre.Administrimi e shitblerja e shoqerive te tjera tregtare edhe jashte vendit.Shitjen e polizave te sigurimit te kompanive te sigurimit shqiptare e te huaja.

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent,

**AKT THEMELIMI "GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM, TRAVEL AND TRANSPORT" SHPK**

Ilirmore Dushaj  
jo

Dalil Abunaj  
D. D. Abunaj



mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve të ndryshme. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

## NENI 6

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njëqind mijë Leke), i ndare në 2 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zotërohet nga:

1- TALAL ABU MAYHA	50,00 %
2- MIMOZA MURATI	50,00 %

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dytë.

## NENI 7

### AKTET E SHOQERISE

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të percaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM, TRAVEL AND TRANSPORT" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratori të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emëruar Talal Abu-Mayha.

## NENI 9

### DISPOZITAT E FUNDIT

AKT THEMELIMI "GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM, TRAVEL AND TRANSPORT" SHPK

4

Mimoza Murati

Talal Abu-Mayha

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.


Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 28.05/2024

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE  
“GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM,  
TRAVEL AND TRANSPORT” SH.P.K.**

**MIMOZA MURATI**  
**TALAL ABU MAYHA**

*Mimoza Murati* 

  
*Talal Abu Mayha*

**AKT THEMELIMI “ GENERAL AUTHORITY FOR TOURISM, TRAVEL AND  
TRANSPORT” SHPK**

5